# AKT THEMELIMI
# I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
# "ORA" SH.P.K.

Sot më date 22.11.2006,

Ilda Prifti, e bija e Jeronimit, datelindja 28.04.1988, vendlindja Lushnje, dhe banuese ne Tirane, në adresën Rruga "Irfan Tomini" Pallati 35/2, ka vendosur të nënshkruajë aktin e themelimit të mëposhtëm një shoqëric me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin nr. 7638 dtaë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" me kushtet si më poshtë:

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqerisë është "ORA" Sh.p.k.

**Neni 2- Selia**

Selia e Shoqërisë "ORA" SH.P.K. është në Rruga "Irfan Tomini" P.Nr.35/2 Tirane

**Neni 3 – Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë është 25 vjet.

**Neni 4 – Objekti i shoqërisë**

Shoqëria "ORA" Sh.p.k., ka si objekt veprimtarie:

4.1 Aktivitetin radioteleviziv privat vendor. Ajo përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kabllove, Satelitit etj, duke respektuar paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të tij.
Shoqëria mund të financohet nëpërmjet reklamës dhe sponsorizimeve në përputhje me sa parashikon legjislacioni në fuqi.

4.2 Aktiviteti i Shoqërisë do të zhvillohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe në mënyrë të veçantë me ligjin nr. 7638, të datës 19 nëntor 1992, *"Për Shoqëritë Tregtare"* siç është ndryshuar, dhe ligjin nr. 8410, i datës 30 shtator 1998 *"Për radion dhe televizionin publik në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar*

**Neni 5 – Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100 (njëqind) pjesë, të gjitha të nënshkruara dhe të shlyera, me vlerë nominale 1.000 (njëmijë) lekë secila.
Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 100 (njeqind mijë) lekë. Ai është I ndarë në 100 pjesë, ku secila ka një vlerë prej 1000 (njëmijë) lekë të renditura nga

numuri një deri në njëqind, të cilat janë krejtësisht të shlyera nga Shoqëria. Ortaku I vetëm ka të drejtën e zmadhimit ose zvogëlimit të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë.
Ortaku i vetëm i shoqërisë është znj. Ilda Prifti, e bija e Jeronimit, datelindja 28.04.1988, Vendlindja Lushnje, dhe banuese në Tiranë ne adresën Rruga "Irfan Tomini", P. Nr 35/2.

Ortak i Vetëm i Shoqërisë , Ilda Prifti, zotëron 100 pjesë kapitali të barabarta me 100% të kapitalit të Shoqërisë dhe që i korrespondon shumës prej 100.000 Lekë:
Kontributi i Ortakut të Vetëm është derdhur pranë Tirana Bank, ne llogarine bankare hapur ne emër të shoqerise "ORA" sh.p.k. në themelim e sipër

**Neni 6 -Transferimi i Pjesëve të Kapitalit**

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme. Transferimi i kapitalit ose i pjesëve të tij bëhet me akt noterial.

**Neni 7- Administratori**

Vendimet e shoqërisë merren nga ortaku i vetëm. Ortaku i vetëm ka të drejtë ti delegojë kompetencat e tij një përfaqësuesi, të cilin e pajis me prokurë sipas kërkesave të Ligjit.

Administratori i Shoqërisë "ORA" është Ilda Prifti, e cila kryen funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretër në të gjithë veprimtarinë e saj.

Kompetencat e Administratorit në Shoqëri janë:
- Të miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në kuadrin e veprimtarisë së Shoqërisë.
- Të përcaktojë strukturën e shoqërisë.
- Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtarët e komisionit të likujdimit dhe ti miratojë me cilësinë e ortakut.
- Të përcaktojë numrin e punonjësve të shoqërisë dhe pagat e tyre.

Administratori I delegon kompetencat e tij një përfaqësuesi tjetër me prokurë sipas kërkesave të ligjit.
Në kuptim të nënit 8 të Statutit të Shoqërisë ORA sh.p.k Administratori delegon kompetencat e tij Av. Erinda Ballanca për rregjistrimin e shoqërisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 8**

Ky Akt themelimi është hartuar në Tiranë, më 22 / 11/2006 për shoqërinë "ORA"sh.p.k në gjuhën shqipe.

Lexuar, nënshkruar dhe miratuar | Tiranë, më 22/11/2006

PËR SHOQËRINË "ORA" SH.P.K

ILDA PRIFTI

Ortak I Vetëm

Ilda Prifti

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 2785 Rep.
Nr. 619 Kol.

# VERTETIM

Sot me daten 22 Nentor 2006 (dymije e gjashte ) u paraqit personalisht ILDA PRIFTI, e bija e Jeronimit, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e saj u njoha nga dokumenti i paraqitur, e cila deklaroi se sa me siper eshte bere ne baze te vullnetit te saj te lire dhe te plote, jashte kesaj zyre, prandaj e nenshkruan ate rregullisht dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

BULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

NOTERE
Meri Cala

# STATUT
# I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
# "ORA" SH.P.K.

## KAPITULLI I
## FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

### Neni 1 – Forma

1.1. Shoqëria "ORA" Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.

1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

### Neni 2 – Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "ORA" Sh.p.k.

### Neni 3 – Objekti i shoqërisë

Shoqëria "ORA" Sh.p.k., ka si objekt veprimtarie

3.1 Aktivitetin radiotelevidiv privat vendor. Ajo përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kabllove, Satelitit etj, duke respektuar paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të tij.

3.2 Shoqëria mund të financohet nëpërmjet reklamës dhe sponsorizimeve në përputhje me sa parashikon legjislacioni në fuqi.

3.3 Aktiviteti i Shoqërisë do të zhvillohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe në mënyrë të veçantë me ligjin nr. 7638, të datës 19 nëntor 1992, *"Për Shoqëritë Tregtare"* siç është ndryshuar, dhe ligjin nr. 8410, i datës 30 shtator 1998 *"Për radion dhe televizionin publik në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.*

### Neni 4 – Selia

Selia e Shoqërisë "ORA" SH.P.K është në Rruga "Irfan Tomini" P.Nr.35/2 Tirane.

### Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

Kohëzgjatja e veprimtarisë është 25 vjet.

## KAPITULLI II

## KAPITALI THEMELTAR

### Neni 6 – Kapitali themeltar

6.4. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë.

6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100 (njëqind) pjesë, të gjitha të nënshkruara dhe të shlyera, me vlerë nominale 1.000 (njëmijë) lekë secila. Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 100 (njëqind mijë) lekë. Ai është I ndarë në 100 pjesë, ku secila ka një vlerë prej 1000 (njëmijë) lekë të renditura nga numuri një deri në njëqind, të cilat janë krejtësisht të shlyera nga Shoqëria. Ortaku I vetëm ka të drejtën e zmadhimit ose zvogëlimit të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë.

Ortaku i vetëm i shoqërisë është znj. Ilda Prifti, e bija e Jeronimit, datelindja 28.04.1988, Vendlindja Lushnje, dhe banuese në Tirane ne adresën Rruga "Irfan Tomini", P. Nr 35/2.

Ortak i Vetëm i Shoqërisë , Ilda Prifti, zotëron 100 pjesë kapitali të barabarta me 100% të kapitalit të Shoqërisë dhe që i korrespondon shumës prej 100.000 Lekë;

6.3 Kontributi i Ortakut të Vetëm është derdhur pranë Tirana Bank, ne llogarine bankare hapur ne emër të shoqërise "ORA" sh.p.k. në themelim e sipër.

### Neni 7 -Transferimi i Pjesëve të Kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme. Transferimi i kapitalit ose i pjesëve të tij bëhet me akt noterial.

## KAPITULLI III

## ADMINISTRIMI

### Neni 8 Administratori

Vendimet e shoqërisë merren nga ortaku i vetëm. Ortaku i vetëm ka të drejtë ti delegojë kompetencat e tij një përfaqësuesi, të cilin e pajis me prokurë sipas kërkesave të Ligjit.

Administratori i Shoqërisë "ORA" është Ilda Prifti, e cila kryen funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në të gjithë veprimtarinë e saj.

Kompetencat e Administratorit në Shoqëri janë:

- Të miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në kuadrin e veprimtarisë së Shoqërisë.
- Të përcaktojë strukturën e shoqërisë.

Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtarët e komisionit të likujdimit dhe ti miratojë me cilësinë e ortakut.
Të përcaktojë numrin e punonjësve të shoqërisë dhe pagat e tyre.

Administratori I delegon kompetencat e tij një përfaqësuesi tjetër me prokurë sipas kërkesave të ligjit.

## KAPITULLI IV

## VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

### Neni – 9 Viti financiar dhe bilanci vjetor

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së rrethit Gjyqësor - Tiranë dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet, operacionet e veprimtarisë së vitit financiar dhe raportet e decanta të hartuara nga esperti kontabël i autorizuar miratohen nga ortaku i vetëm.

Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

### Neni 10- Fitimi i realizuar

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha detyrimet si dhe fondet e lëna rezervë për nxitjen ekonomike, për investime, për reklamën tregtare etj, i kalon Ortakut të vetëm.

## KAPITULLI V
## SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

### Neni 11- Prishja

Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të ortakut të vetëm apo në rastet e parashikuara nga ligji.

Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve

## Neni 12- Likujdimi

...rast të prishjes, Shoqëria duhet të likujdohet.

...për të administruar këtë procedurë, Ortaku I vetëm emëron një ose disa likuidatorë, të ...cilët do të paraqesin raportin përfundimtar të likuidimit mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

- Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Ortaku I vetëm merr vendim lidhur me bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesi/t dhe përfundimin e procesit të likuidimit.

- Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori/ët do t'ia shpërndajnë fitimin që mbetet pas likuidimit Ortakut të vetëm.

## KAPITULLI IV
## DISPOZITAT E FUNDIT

### Neni 13

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për shqyrtimin e tyre është Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

### Neni 14

Ky Statut është hartuar në Tiranë, më 22/ 11/ 2006 për shoqërinë ORA sh.p.k në gjuhën shqipe.

Tiranë, më 22 / 11/ 2006

Lexuar, nënshkruar dhe miratuar

PËR SHOQËRINË "ORA" SH.P.K

ILDA PRIFTI

Ortak I Vetëm

Ilda Prifti

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 2784 Rep.
Nr. 618 Kol.

VERTETIM

Sot me daten 22 Nentor 2006 (dymije e gjashte) u paraqit personalisht ILDA PRIFTI, e bija e Jeronimit, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e saj u njoha nga dokumenti i paraqitur, e cila deklaroi se sa me siper eshte bere ne baze te vullnetit te saj te lire dhe te plote, jashte kesaj zyre, prandaj e nenshkruan ate rregullisht dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE

Mesi Cela

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE